

VENDIM
Nr.1071, datë 21.10.2009

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE, TË KRYEJË
PROCEDURËN E PROKURIMIT, ME OBJEKT “BLERJEN DHE INSTALIMIN E 26
KABINAVE TË KONTROLLIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 9 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të kryejë, brenda datës 30 nëntor 2009, procedurën e prokurimit, me objekt “Blerjen dhe instalimin e 26 kabinave të kontrollit”. Brenda këtij afati të përfshihet edhe lidhja e kontratës përkatëse.

2. Fondi limit, prej 18 120 000 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet mijë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha